

APLIKIM PËR NË QENDRAT REZIDENCIALE

<u>Emri i Shërbimit</u>	Kërkesë për qëndrim në qendrat rezidenciale
<u>Përshkrim i Shkurtër</u>	<p>Shërbimi në institucionet rezidenciale ofrohet për individë, për të cilët përkujdesi në shtëpi nuk është i mundur. Vendosja e tyre në qendrat e për kujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e personit ose përfaqësuesit e tij ligjor, pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të tij.</p> <p>Personat, që kanë nevojë për shërbime të për kujdesit shoqëror, pranohen në institucionet rezidenciale, publike, pa pagesë, nëse familjet e tyre nuk kanë asnjë të ardhur. Shpenzimet e tyre mbulohen nga buxheti i shtetit.</p> <p>Personat që kanë nevojë për shërbime të për kujdesit shoqëror, dhe kanë të ardhura personale, pranohen në institucionet publike të për kujdesit, kundrejt një pagese në raport me të ardhurat e tyre mujore ose të ardhurat e individëve të tjerë përgjegjës. Masa e kontributit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>Përfituesve të shërbimeve të për kujdesit shoqëror që vendosen në institucionet e për kujdesit, u jepen në dorë një shumë në lekë për shpenzime personale. Kjo shumë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.</p>
<u>Baza ligjore:</u>	<ul style="list-style-type: none">▪ Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”▪ Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 Kodi i Procedurave Administrative▪ Ligj nr. 9355, datë 10.03.2005, “ Për Ndhimën Dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar me ligjin nr.10399, datë 17.03.2011,▪ Vendimin nr. 425, dt.27.06.2012 “Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe private, të për kujdesit shoqëror”.
<u>Përfituesi</u>	Qytetarët
<u>Zyra Përgjegjëse</u>	DKS – Drejtoria e Kujdesit Social, Sektori i Shërbimeve Sociale
<u>Afati</u>	
<u>Tarifa</u>	Nuk ka tarifë